

Udhëzime dhe informacione për Tenderuesit

PËR NE



Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME



Kjo pjesë ofron udhëzime të hollësishme që duhen ndjekur për t'iu përgjigjur kësaj FPP-je. Të përfshira janë Udhëzimet dhe Informatat për KCSF-në. Lëshuesi i kësaj dosjeje të tenderit është referuar si "Autoriteti Kontraktues".

Autoriteti Kontraktues i cekur në Ftesën për Propozime, lëshon këtë Dosje të Tenderit për prokurim të Shërbimeve/Furnizimeve siç është specifikuar në Termat e Referencës, Aneksi 1.

Titulli i kontratës dhe numri identifikues i këtij aktiviteti të prokurimit janë të shënuara në Ftesën për Propozime.

Përveç nëse është shënuar ndryshe në FDT, Autoriteti Kontraktues prokuron vetëm në emër të tij.

Nga ju kërkohet të paraqisni një propozim me shkrim sipas formatit në Formularin e përcaktuar. Personi përgjegjës për propozimin duhet të nënshkruajë dhe vulosë Ofertën. Në tërë këtë dosje të tenderit ju referoheni si "Operatori Ekonomik" ose "Tenderuesi".

Tenderuesit duhet t'i përmbahen të gjitha kërkesave të këtij tenderi, përfshirë çdo ndryshimi me shkrim nga KCSF-ja. Kjo procedurë e tenderimit është e rregulluar në përputhje me POLITIKAT DHE PROCEDURAT E PROKURIMIT të KCSF-së dhe rregullave dhe praktikave të prokurimit të nxjerra ne përputhshmëri me të.

Objektivi kryesor i KCSF-së për prokurim, janë politikat e konkurrencës së hapur dhe të ndershme për të gjithë operatorët që ofrojnë furnizime, punë dhe shërbime nga të gjitha vendet e ndryshme në mënyrë që të arrihet oferta me vlerën më të mirë për paratë.

Mashtrimi, korrupsioni, dhuratat dhe etika e prokurimit



KCSF zbaton në mënyrë rigorozë politikën e tolerancës zero ndaj praktikave të ndaluara, duke përfshirë mashtrim, korrupsion dhe marrëveshjet e fshehta, praktikat joetike ose joprofesionale dhe kërkon që të gjithë ofertuesit të respektojnë standardet më të larta të etikës gjatë procesit të prokurimit dhe zbatimit të kontratës.

Konflikti i interesit



Çdo situatë e konfliktit të interesit me tenderuesit duhet të deklarohet në organizatë në përputhje me Politikën e KCSF-së për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Të gjithë tenderuesit duhet të tregojnë ndonjë konflikt aktual ose të mundshëm të interesit dhe marrëdhëniet ekzistuese të biznesit që mund të kenë me KCSF, bordin e drejtorëve, zyrtarët apo punonjës të caktuar para dorëzimit të ofertës. Tenderuesit duhet të

shmangin në mënyrë rigoroze konfliktet ose interesat e tyre personale . Tenderuesit që zbulohet se kanë konflikt interesi do të skualifikohen.

TERMAT DHE KUSHTET

Konsideratat e përgjithshme



KCSF rezervon të drejtën të modifikojë dispozitat e kësaj FPP-je në çdo kohë para datës së caktuar për përgjigjejet me shkrim. Mund të shtohet fushëveprimi dhe të ketë kërkesa shtesë. Njoftimi për ndryshime të tilla do t'i ofrohet të gjithë tenderuesve.

Tenderuesit duhet të kontrollojnë që të gjitha dokumentet e cekura në Dokumentet e ftesës për tender janë pranuar dhe janë të plota në të gjitha aspektet. Asnjë pretendim që del nga dështimi për të studiuar detajet e përfshira këtu ose për të marrë informacion e tillë nuk do të merret në konsideratë nga KCSF.

Ofertat e pranuar pas datës së pranimit të kërkesës të përcaktuar në ftesën për propozime ose të dorëzuara në mënyrë jo të saktë në përputhje me këto udhëzime, mundet që, me diskrecionin e vetëm të KCSF-së, të mos merren parasysh dhe të kthehen mbrapa dhe refuzohen.

Nëse tenderuesit kanë ndonjë pyetje ose kërkesë për informacion shtesë, ato duhet të dorëzohen tek personi i autorizuar në Ftesën për Propozime.

Të gjitha komunikimet në lidhje me këtë ftesë për propozime duhet të jenë vetëm me personin e autorizuar në ftesën për propozime. Tenderuesit paralajmërohen se çdo komunikim tjetër qoftë me shkrim ose jo, nuk do të jetë pjesë e çfarëdo kontrate dhe mund të rezultojë në skualifikimin e ofertimit të tyre.

KCSF rezervon të drejtat për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar ose kërkesat për shpjegime shtesë nga tenderuesit.

Asnjë Ofertë dhe asnjë pjesë e saj nuk do të konsiderohet se është miratuar, përveç nëse për miratimin e tillë tenderuesi është njoftuar me shkrim nga KCSF. KCSF rezervon të drejtat për të ndërprerë ose modifikuar këtë ftesë për propozime dhe për ta rishpallur ftesën për propozime.

Para dhënies së kontratës, KCSF mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë ose të kërkoj intervista të shpejta për të ndihmuar procesin e vlerësimit.

Struktura dhe përmbajtja e dosjes



Ftesa për Propozime

Shtojca 1: Termat e referencës dhe përshkrimi i shërbimit

Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesit

Shtojca 3: Formulari i propozimit financiar

Shtojca 4: Udhëzime dhe informacione

Formati dhe përmbajtja e propozimit financiar, Kushtet e Kontratës dhe lloji i kontratës

Nga tenderuesit kërkohet të paraqesin Propozimin Financiar duke përdorur modelin e dhënë në këtë dosje të tenderit Shtojca 3. Gjithashtu është obligative të paraqesin deklaratën nën betim duke përdorur modelin e dhënë.



Sasitë e vlerësuara janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë autoritetin kontraktues për të blerë ndonjë prej tyre. Autoriteti kontraktues ka lirinë e veprimit për të blerë më pak ose më shumë sasi se sa sasitë e vlerësuara për artikull.

Kontrata për këtë aktivitet të prokurimit do të jetë kontratë për shërbime.

Sqarimi i dosjes së tenderit



Tenderuesit mund të kërkojnë sqarime për cilindo nga dokumentet e dosjes së tenderit jo më vonë se data e përcaktuar për pyetje. Çdo kërkesë për sqarim duhet të dërgohet me shkrim.

DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE

Dorëzimi i ofertave



Ofertimet duhet të dorëzohen në përputhje me këto udhëzime dhe dokumentet e tjera të kërkuara tek **Dokumentet që do të dorëzohen** së bashku me të gjitha informacionet e tjera përkatëse të kërkuara për të përshkruar Propozimin jo më vonë se koha dhe data e përcaktuar në ftesën për propozime.

Tenderuesit duhet të paraqesin Ofertën e nënshkruar, vulosur dhe të plotë, që përfshin dokumentet dhe formularët në përputhje me Formatin dhe Përmbajtjen në tender.

Tenderuesit do të mbartin të gjitha kostot dhe shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimit e Ofertës.

Afati i fundit për Dorëzimin e Ofertave dhe Tenderët e Vonuar



Oferta duhet të dorëzohet nëpërmjet postës elektronike në emailin e dhënë jo më vonë se afati i caktuar me titullin duke përfshirë numrin përkatës të referencës. Të gjitha dokumentet e dorëzuara duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përshkruara në ftesë. I gjithë Propozimi duhet të plotësohet me të gjitha shtojcat e kërkuara të kësaj dosje për tender. Dokumentet e pranuar pas afatit nuk do të merren parasysh.

Ose

Oferta duhet të dorëzohet në kopje fizike, në një zarf të mbyllur e të vulosur, në adresën e shënuar në ftesën për tender me titullin e referencës së kësaj thirrje dhe mbishkrimin "Mos të hapet para datës së përcaktuar"

Dokumentet e pranuar pas afatit nuk do të merren parasysh.

Refuzimet



Tenderi juaj mund të refuzohet nëse nuk jepni përgjigje të kënaqshme për pikat në vijim:

- Është dënuar organizata juaj, ndonjë drejtor ose partner apo ndonjë person tjetër që ka kompetenca përfaqësimi, apo është nën hetime disiplinore për konkurrencë joligjore, shkelje të sekreteve, përvetësim apo keqpërdorim të pronësisë intelektuale apo keqpërdorim ose zbulim të paautorizuar të informacioneve të brendshme të Punëdhënësit ose organizatave/kompanive pranuese të shërbimeve të tij.
- Gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimi të urdhrit për likuidim ose përmbyllje të aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër.

Kapaciteti/Aftësia Teknike dhe përshtatshmëria

- Mos dhënia e detajeve për projektet të ngjashme në tre vitet e fundit
- Mos-pajtueshmëria me Dokumentacionin e Ftesës për Propozime
- Nuk ofron dëshmi të dokumentuara për kërkesat e përshtatshmërisë:
 - një deklaratë me shkrim nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.
 - Nuk dorëzoni ofertën në përputhje me specifikimet dhe/ose kërkesat e tjera thelbësore.

Ankesat



Tenderuesit që e konsiderojnë veten të trajtuar në mënyrë të padrejtë mund të paraqesin ankesë pranë Autoritetit Kontraktues.

Për cilëndo arsye të parashtrimit të ankesës, të njëjtat duhet të parashtrihen në afat prej 5(pesë) ditëve nga dita kur palët janë njoftuar, respektivisht kur është bërë njoftimi zyrtar lidhur me procedurën e zhvilluar. Ankesat e ofertuesve parashtrihen pranë Menaxhmentit të KCSF-së, i cili do të vendos për ankesat eventuale, jo më larg se 30 ditë nga dita kur është dorëzuar ankesa.

VLERËSIMI I TENDERËVE

Ekzaminimi dhe vlerësimi i Tenderëve



Informacioni në lidhje me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve dhe rekomandimi për dhënien e kontratës, nuk do t'i zbulohen Tenderuesve ose personave të tjerë që nuk kanë të bëjnë zyrtarisht me një proces të tillë, edhe pas publikimit të dhënies së kontratës.

KCSF do të shqyrtojë ofertat për të përcaktuar nëse ato janë të plota, nëse informacioni i kërkuar është siguruar siç është theksuar në Ftesën për Propozime, nëse dokumentet janë nënshkruar si duhet, dhe nëse ofertat janë përgjithësisht në rregull. Pranueshmëria dhe pajtueshmëria me të gjitha format dhe dokumentet mundëson të kalojë në nivelin tjetër të vlerësimit. Vetëm ato oferta që përputhen me kriteret e pranueshmërisë do të merren për vlerësim të mëtejshëm teknik.

Në vlerësimin e tenderëve do të përdoren dy mënyra: Faktorët e Vlerësimit Teknik dhe Faktorët e Vlerësimit Financiar. Peshimi i pikëve do të jetë sipas tabelës dhe faktorëve më poshtë në këtë dosje të tenderit.

Ofertat e përgjegjshme do të vlerësohen dhe krahasohen sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në këtë dosje të tenderit. Operatori ekonomik i cili ka dorëzuar ofertën e renditur më së larti sipas rezultatit, do të shpërblehet me kontratë.

Pyetjet dhe Përgjigjet



Pyetjet: Pyetjet në lidhje me kërkesat teknike të kësaj Ftese për Propozime mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike në adresën e shënuar në ftesën e propozimeve. Çdo informacion verbal i marrë nga punonjësit e KCSF-së ose ndonjë entitet tjetër nuk do të konsiderohet si përgjigje zyrtare e KCSF-së në lidhje me këtë ftesë për propozime.

Ju kujtojmë se gjatë gjithë procesit, KCSF vazhdimisht do të vlerësojë të gjitha kontaktet e tenderuesve duke përfshirë pajtueshmërinë me procesin, prezantimet e përfaqësuesve të tyre dhe KCSF rezervon të drejtën në diskrecionin e saj të skualifikoj pa shqyrtim të mëtejshëm çdo aplikacion që nuk e plotëson këtë kërkesë bazë.

Përgjegjshmëria e tenderuesve



Përcaktimi i përgjegjshmërisë së një Oferte nga KCSF do të bazohet në përmbajtjen e Propozimit/Ofertës. Një Propozim/Ofertë është substancialisht i/e përgjegjshëm/e nëse i plotëson të gjitha termet, kushtet, TeR dhe kërkesat e tjera të tenderit pa devijim material, rezervë ose lëshim.

Një tender konsiderohet të jetë përgjegjës kur:

- a. përputhet në aspektin administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. përputhet në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosjen e tenderit;
- c. është dorëzuar informacion i bollshëm nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.

Nëse një Propozim/Ofertë substancialisht nuk është i përgjegjshëm, do të refuzohet nga KCSF dhe nuk mund të bëhet më pas i përgjegjshëm me korrigjimin e devijimit material, rezervimit apo lëshimit.

Informimi për pjesëmarrësit e pasuksesshëm



KCSF do të ofrojë informatë për rezultatin për secilin Tenderues që paraqet një ofertë të pasuksesshme, KCSF rezervon të drejtën për të kontrolluar formatin dhe përmbajtjen e çdo informimi të tillë, dhe për ta kufizuar atë në çdo mënyrë që besohet nga KCSF të jetë e përshtatshme (çka përfshin, në rrethana të jashtëzakonshme, të drejtën për të refuzuar një ofertë pa dhënë ndonjë arsye për këtë).
